



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 482, datë 13.09.2023**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË LISTËN E GJYQTARËVE UDHËHEQËS TË CAKTUAR ME  
VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 466, DATË 25.07.2023, TË  
NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.470, DATË 26.07.2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 dhe 97, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 14 dhe 33 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023, të ndryshuar me vendimin nr.470, datë 26.07.2023 gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} me gjyqtarët: {...} në sesionin e parë 4-mujor (korrik – tetor 2023); {...} në sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe {...} në sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).
  2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**